

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Specialist Risku

Ne baze te ligjit te Agjencise te Trajtimit te Kredive dhe rregullores se saj

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar ;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- të ketë kryer studimet e larta , të nivelit Master Shkencor në Shkencat Ekomonike /Juridike;
- të ketë pervoje pune me shume se 1 vit ne administraten publike ose pervojë pune ne sektorin privat;
- të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- zoterimi i nje gjuhe te huaj perben avantazh
- të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup.

Përgjegjësitë

Detyrat e *Specialistit të Riskut* :

- Analizon të gjithë portofolin e kredive të transferuara nga ish bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror dhe “INSIG” sha, duke marrë në konsideratë dhe duke bërë kategorizime.
- Llogarit riskun për çdo debitor që ka bërë kërkesë për ristrukimim detyrimi, për zëvendësim, kolaterali, zëvendësim debitori, pasi ka kryer verifikimet e të dhënave të dosjes së debitorit dhe ka marrë informacionin e duhur nga sektorët përkatë.

Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit :

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Kërkesë me shkrim
- Curriculum vitae
- Libreza e punes
- Deshmi Penaliteti

Aplikimet duhet të dërgohen në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Agjensia e Trajtimit të Kredive

Njësia Administrative nr.5, Tiranë Rruga “Dora D’Istria”, Ndërtesa 22 Hyrja 1. Kodi 3771821017

Afati

Aplikimet pranohen deri në datën 21 Janar 2022, ora 12. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumentave vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.